



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR PROMOVIM DHE MBËSHTETJE TË TURIZMIT

Në bazë të nenit 2, kreu a), pika 4 e Programit të Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit për vitin 2019 ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 16/2019) dhe nenit 3 të Rregullores për blerjen e fotografive me motive dhe lokacione turistike për Republikën e Maqedonisë së Veriut nr.02-616/8 të datës 21.08.2019, Komisioni për blerje të fotografive me motive dhe lokacione turistike e formuar me vendimin nr.03-656/1 të datës 02.09.2019

Publikon
THIRRJE PUBLIKE

Për blerje të fotografive me motive dhe lokacione turistike për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit me qëllim rritje dhe nxitje të ofertës turistike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Programin e Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit për vitin 2019 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.16/2019).

I

Lëndë e Thirrjes publike është blerja e fotografive me motive të lokacioneve turistike për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e Agjencisë për mbështetje dhe promovim të turizmit, në pajtim me Programin e Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit për vitin 2019 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.16/19).

II

Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit në pajtim me programin për vitin 2019 ka përcaktuar mjete në shumën prej 600.000,00 denarëve, që do të paguhen nga pika 425 nga llogaria e buxhetit.

Blerja do të realizohet përmes:

- Blerjes së fotografive me motive të lokacioneve turistike të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat deri tani aspak nuk janë shfrytëzuar për qëllime tjera.
- Numri maksimal i fotografive të blera nga një ofertues është 10, në shumën prej 3.000,00 denarë për fotografi.

III

Në thirrjen publike të drejtë në paraqitje kanë të gjithë subjektet e interesuar, juridik dhe fizik, të cilët merren me përpunimin dhe prodhimin e materialeve për foto dhe video.

IV

Nëse bëhet fjalë për subjekt fizik, i njëjti duhet të parashtojë deklaratë për të drejta autoriale ndaj fotografive, në pajtim me Ligjin për të drejtën autoriale dhe të drejtat e lidhura (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 23/2005, 115/2010, 140/2010, 51/2011, 147/2013, 154/2015 dhe 27/2016) dhe deklaratë të nënshkruar që fotografitë nuk janë publikuar më parë ose shfrytëzuar për qëllime tjera.

Nëse bëhet fjalë për subjekt juridik/kompani duhet të parashtojë deklaratë me shkrim nga autori i fotografisë, si dhe deklaratë për vendosje të drejtave autoriale për fotografitë e përzgjedhura të kompanisë e cila disponon me të njëjtat, si dhe deklaratë që fotografitë nuk janë publikuar më parë ose shfrytëzuar për qëllime tjera.

Në bashkëngjitje me kërkesën, subjektet juridike duhet ta parashtrorjnë dokumentacionin në vijim:

1. Vendim për regjistrim DRD formular (origjinal ose kopje me vulë dhe nënshkrim të parashtruesit);
2. Vërtetim për tatime, të ardhura dhe kontribute tjera të paguara nga organi kompetent.

V

Mjetet për blerje të fotografive me motive të lokacioneve turistike do të bëhen në bazë të vlerësimit për përmbushjen e specifikimit në vijim dhe kriterëve në vijim:

Kriteret
Fotografitë duhet të parashtrohen në formatin digjital JPEG dhe në format të shtypur, me rezolucion mes 1-5mb
Fotografitë nuk duhet të jenë më të vjetra se 1 vit
Fotografitë nuk duhet të jenë të publikuara më parë në gazeta, katalogë, revista ose të kenë marrë pjesë në konkurse tjera

Specifikimi
Të gjitha parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura
Pejsazhe malore në katër stinët e vitit
Turizmi aktiv - ngjitje nëpër shkëmbinj, paraglajding, çiklizëm, kajak, kamping, shikimin e zogjve, skijim dhe sporte tjera ekstreme dhe aktivitete të jashtme
Qytetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Shkup, Ohër, Strugë, Vevçan, Dibër, Krushevë, Manastir, Prilep, Veles, Kumanovë, Kratovë, Berovë, Strumicë, Shtip, Dojran, Resnjë, Prespë, Tetovë
Përmendore kulturore historike - tradita, folklor dhe manifestime

Përparësi do të kenë fotografitë që do të përmbajnë lokacione të njohura turistike, atraksione dhe zanate lokale.

Komisioni është i obliguar në afat prej 10 ditëve pas afatit përfundimtar për parashtrimin e kërkesave të bëj një rang listë, në pajtim me specifikimin dhe kriteret e lartpërmendura.

Blerja e fotografive me motive të lokacioneve turistike do të bëhet deri sa të shpenzohen mjetet nga neni 2.

VI

Kërkuesit sipas rregullores duhet t'i parashtrojnë dokumentet në vijim:

1. Kërkesë për konkurs në 2 kopje e cila përmban emrin dhe mbiemrin (nëse bëhet fjalë për subjekt fizik), ose emrin e kompanisë (nëse bëhet fjalë për subjekt juridik) me titull: PËR THIRRJEN PUBLIKE PËR BLERJEN E FOTOGRAFIVE

3. Portofolio elektronike (CD) e cila do të përmbajë së paku 5 fotografi, ndërsa më së shumti 30 nga lokacionet turistike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Dokumentet parashtrohen përmes postës ose direkt në Arkivin e Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit, në zarf të mbyllur në të cilin në anën e sipërme të majtë do të theksohet MOS E HAP,

përderisa kërkesa për paraqitje do të vendoset në vet zarfin në të cilin do të mund të bëhet pranim në Arkivin e Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit, por jo më vonë se afati i paraparë.

Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit e mban të drejtën për përcjellje të realizmit të thirrjes, kontroll të shpenzimit të mjeteve, si dhe kthimin e tyre nëse përcaktohen çfarë do parregullsi, në pajtim me Rregulloren nr.02-616/8 prej datës 21.08.2019.

VII

Pas vendimit të sjellur për kërkesat kualifikuese, fituesi duhet t'i parashtrojë në afat prej 10 ditëve:

- 50% nga fotografitë e ofruara të jenë vertikale dhe 50% horizontale në TIFF format digjital me **rezolucion të lartë 300 DPI** me madhësi prej:
për horizontalen minimum - gjerësia 5000 pikselë, lartësia 3000 pikselë;
për vertikalen minimum - gjerësia 3000 pikselë, lartësia 5000 pikselë.
- Fotografitë duhet të jenë me lokacion të theksuar dhe numër rendor treshifror (psh. jpg 005).
- Fotografitë e përzgjedhura të parashtrohen në format origjinal, gjegjësisht fotografi 30/40cm, në TIFF format digjital, me rezolucion të lartë adekuate për shtypje të posterëve prej 20 deri 100mb.

Ofertuesi është i obliguar fotografinë ose fotografitë t'i parashtrojë tërësisht të përpunuara artistikisht dhe grafikisht.

VIII

Fotografitë që përmbajnë modele (persona) duhet të parashtrohen me marrëveshje për pajtueshmëri nga personi që është fotografuar (Model Release marrëveshje), nëse bëhet fjalë për fotografi me persona të mitur patjetër dhe dëshmi për pajtueshmëri nga prindi ose kujdestari. Për blerjen e këtij lloji të fotografive Agjencia nuk ka obligim të paguajë asnjë kompensim personit që është fotografuar.

IX

Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit, si dhe Komisioni nuk mbajnë përgjegjësi në rast të keqpërdorimit të drejtave autoriale nga ana e vet pjesëmarrësve ose persona të tretë për fotografitë e paraqitura në konkursin.

Të punësuarit e agjencisë si dhe anëtarët e komisionit nuk kanë të drejtë në pjesëmarrje në thirrjen publike.

X

Afati për parashtrimin e aplikimit është 01.12.2019, ndërsa kërkesën për paraqitjen në thirrjen publike, parashtruesit mund ta gjejnë në ueb faqen oficiale të Agjencisë www.tourismmacedonia.gov.mk.

Kërkesat e vonuara dhe jo të plota, nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit të Agjencisë për promovim dhe mbështetje të turizmit.

Kandidatët që nuk do të zgjidhen në thirrjen publike do të njoftohen në afat prej 15 ditëve.